FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 5

Tiranë – E enjte, 13 janar 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 124/2021, datë 16.12.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për ripranimin e personave dhe protokollit zbatues të marrëveshjes.....	635
Ligj nr. 127/2021, datë 20.12.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 34, datë 3.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020, 'Për buxhetin e vitit 2021', të ndryshuar".....	662
Ligj nr. 130/2021, datë 20.12.2021	Për një ndryshim në ligjin nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.....	662
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 1, datë 6.1.2022	Për delegim kompetence.....	662
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 246, datë 13.12.2021	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2021.....	663
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 247, datë 13.12.2021	Mbi fillimin e procedurës për disa shtesa në rregulloren "Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes", miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar.....	664
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 248, datë 13.12.2021	Mbi rishikimin e vendimit nr. 110, datë 26.4.2021, "Mbi kërkesën e shoqërisë *"Biopower Green Energy"* sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 35, datë 4.2.2021, "Mbi kërkesën e shoqërisë *'Biopower Green Energy'* sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar".....	665
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 249, datë 13.12.2021	Mbi rishikimin e vendimit nr. 111, datë 26.4.2021, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'E-Vento s.r.l. Albania' sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2021, 'Mbi kërkesën e shoqërisë 'E-Vento s.r.l. Albania' sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar"'.....	667

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 250, datë 13.12.2021	Mbi rishikimin e vendimit nr. 112, datë 26.4.2021, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Hera' sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 34, datë 4.2.2021, 'Mbi kërkesën e shoqërisë 'Hera' sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar'".....	669
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 251, datë 13.12.2021	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave (nëpërmjet shitblerjes) të shoqërisë "Kalisi Hydropower" sh.p.k. ndërmjet ortakëve ekzistues të shoqërisë.....	671

LIGJ
Nr. 124/2021

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE DHE PROTOKOLLIT ZBATUES TË MARRËVESHJES

Në mbështetje të neneve 78, 83 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:
Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për ripranimin e personave dhe protokollit zbatues të marrëveshjes, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 16.12.2021.

MARRËVESHJE
NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË
MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË
VERIUT MBI RIPRANIMIN E PERSONAVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar së Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, këtu referuar si "Pala Kontraktuese" ose "Palët Kontraktuese" sipas rastit,

Duke dëshiruar të përmirësojnë bashkëpunimin ndërmjet dy Palëve Kontraktuese, me qëllim që të japin kontributin e tyre për të parandaluar dhe luftuar kalimin e paligjshëm të kufirit me qëllim migracionin,

Duke dëshiruar të lehtësojnë ripranimin dhe tranzitin në rastet e dëbimit të personave, hyrja ose qëndrimi i të cilëve është i paligjshëm në territoret e shteteve të tyre,

Duke pasur parasysh nevojën që të udhëhiqen nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat garantohen nga legjislacioni i tyre kombëtar dhe nga marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi për Palët Kontraktuese,

Ranë dakord si më poshtë:

NENI 1

Përkufizime

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje dhe Protokollit të kësaj Marrëveshjeje, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1) "Leje qëndrimi" nënkupton një autorizim i çdo lloji i lëshuar nga njëra Palë Kontraktuese, e cila e lejon personin të qëndrojë në territorin e asaj Pale Kontraktuese, me përjashtim të vizave dhe autorizimeve të përkohshme për qëndrim, lëshuar gjatë shqyrtimit të një aplikimi për një leje qëndrimi ose për azil.

2) "Shtetas" dhe "Shtetësi", në konceptin e Republikës së Shqipërisë i referohen shtetasve shqiptarë dhe shtetësisë shqiptare dhe për sa i përket Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe të Irlandës së Veriut, i referohen vetëm shtetasve britanikë dhe shtetësisë britanike.

3) "E drejta për të qëndruar" zbatohet vetëm për sa i përket Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe të Irlandës së Veriut dhe ka kuptimin që është përcaktuar në legjislacionin përkatës kombëtar.

4) "Vizë" nënkupton një autorizim ose vendim nga një shtet ose territor, përfshirë ndonjë Palë Kontraktuese, e cila e lejon një person të hyjë dhe të mbetet në territorin e shtetit të saj, në rastet kur përmbushen kriteret në bazë të të cilave është lëshuar viza.

5) "Leje për tranzit" nënkupton çdo autorizim ose vendim ose çdo vizë që kërkohet nga një Palë Kontraktuese, të cilat e lejojnë një shtetas të një Pale të Tretë të kalojë tranzit nëpërmjet territorit të shtetit të saj ose të kalojë nëpërmjet zonës tranzit të një porti ose aeroporti, me kusht që kriteret e tjera të tranzitit të jenë të përmbushura.

6) "Shtetas i një pale të tretë" nënkupton një person i cili nuk ka shtetësinë e, ose të drejtën e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë ose në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, dhe "Shtet i palës së tretë" nënkupton çdo lloj vendi ose territori, përveç Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut.

7) "Ditë pune" nënkupton çdo lloj dite e cila nuk është e shtunë, e delë ose ditë feste zyrtare, në secilën prej Palëve Kontraktuese.

8) (a) Në varësi të paragrafit (8) (c) më poshtë, "Autoritetet Kompetente" në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar nënkupton:

i) për dorëzimin e një kërkese tek Autoritetet Kompetente në Republikën e Shqipërisë, pranimin e një përgjigjeje të një kërkese, për procedurën për të marrë një dokument udhëtimi nga përfaqësimi diplomatik-konsullor shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar dhe për të gjitha njoftimet për personat që do të kthehen në Republikën e Shqipërisë:

- Ministria e Brendshme Britanike;

ii) për pranimin e një kërkese nga Autoritetet Kompetente për Republikën e Shqipërisë, për dërgimin e një përgjigjeje ndaj një kërkese dhe për dorëzimin e të gjitha njoftimeve të personave që do të kthehen në Mbretërinë e Bashkuar:

- Ministria e Brendshme Britanike;

iii) për lëshimin e pasaportave dhe dokumenteve të tjera të udhëtimit pas një përgjigjeje pozitive të kërkesës:

- Ambasada e Mbretërisë e Bashkuar në Republikën e Shqipërisë.

(b) Në varësi të paragrafit (8) (c) më poshtë me "Autoritete Kompetente" për Republikën e Shqipërisë nënkupton:

i) për dërgimin e një kërkese tek Autoritetet Kompetente në Mbretërinë e Bashkuar, pranimin e një përgjigjeje të një kërkese, për procedurën për të marrë një dokument udhëtimi nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Shqipërisë, dhe për të gjitha njoftimet për personat që do të kthehen në Mbretërinë e Bashkuar:

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme;

ii) për pranimin e një kërkese nga Autoritetet Kompetente të Mbretërisë së Bashkuar, për dërgimin e një përgjigjeje ndaj një kërkese dhe për dorëzimin e të gjitha njoftimeve të personave që do të kthehen në Republikën e Shqipërisë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në Ministrinë e e Brendshme ;

iii) për lëshimin e pasaportave dhe të dokumenteve të tjera të udhëtimit pas një përgjigjeje pozitive për kërkesën:

- Ambasada ose zyrat konsullore të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar.

(c) Çdo lloj ndryshimi për përkufizimin e "Autoriteteve Kompetente" të njërës nga Palët Kontraktuese do t'i njoftohet Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Çdo ndryshim i këtij lloji do të hyjë në fuqi në ditën e punës, e cila pason marrjen e një njoftimi të tillë nga Pala tjetër Kontraktuese.

9) "Palë Kontraktuese Kërkuese" nënkupton një Palë Kontraktuese, e cila i bën një kërkesë Palës Kontraktuese të kërkuar për të ripranuar një person ose për të lejuar kalimin tranzit, në përputhje me përcaktimet e kësaj marrëveshjeje dhe "Palë Kontraktuese e kërkuar" do të thotë Pala Kontraktuese të cilës i bëhet një kërkesë e tillë.

10) "Fëmijë" ose "Fëmijët" nënkupton persona të cilët nuk kanë arritur moshën 18 vjeç në datën kur është bërë kërkesa për ripranimin.

11) "Me shkrim" nënkupton me shkrim në gjuhën angleze.

PJESA 1

RIPRANIMI I SHTETASVE DHE I PERSONAVE ME TË DREJTË QËNDRIMI

Neni 2

Detyrimi për të ripranuar

1) Një Palë Kontraktuese kërkuese do të ripranojë, me kërkesë të Palës Kontraktuese të kërkuar dhe pa ndonjë formalitet të veçantë, çdo person që nuk plotëson, ose që nuk plotëson më, kërkesat për hyrje ose qëndrim në territorin e Shtetit të Palës Kontraktuese, me kusht që personi të identifikohet si duhet dhe të provohet në përputhje me paragrafin (1) të Nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje ose mund të supozohet në mënyrë të arsyeshme në përputhje me paragrafin (2) të Nenit 3, se ose personi është shtetas, ose person tjetër me të drejtë qëndrimi, në Palën Kontraktuese të Kërkuar, ose personi ishte (në hyrjen e tyre të fundit në territorin e Shtetit të Palës Kontraktuese Kërkuese) një shtetas i Palës Kontraktuese të Kërkuar, por më pas ka hequr dorë nga shtetësia e tij dhe nuk ka fituar ndonjë Shtetësi ose kombësi tjetër.

2). Një Palë Kontraktuese Kërkuese do të ripranojë, me kërkesë të Palës Kontraktuese të kërkuar dhe pa ndonjë formalitet të veçantë, çdo person i cili është larguar më parë nga territori i shtetit të saj në përputhje me paragrafin (1) të këtij Neni, nëse nga verifikimet e mëtejshme rezulton se në kohën e largimit ai person nuk ishte shtetas i saj ose çdo person

tjetër me të drejtën për të qëndruar në Palën Kontraktuese të kërkuar. Në një rast të tillë Pala Kontraktuese e cila e kishte pranuar atë person, do të kthejë të gjitha dokumentet e marra nga Pala tjetër Kontraktuese në lidhje me ripranimin fillestar. Detyrimi për të ripranuar në bazë të këtij paragrafi nuk do të zbatohet në rastet kur Pala Kontraktuese e kërkuar e ka privuar personin në fjalë nga shtetësia e tij/e saj ose nga e drejta për qëndrim, ose në rastet kur personi kishte hequr dorë ose lejuar që t'i hiqet shtetësia e tij/e saj ose e drejta e qëndrimit, pasi ai person kishte hyrë në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese, në rast se atij personi nuk i është bërë të paktën një premtim për natyralizim nga Pala Kontraktuese kërkuese.

Neni 3

Mjetet e përcaktimit të identitetit dhe Shtetësisë së Personave që do të ripranohen

1. Identiteti dhe Shtetësia ose e Drejta për Qëndrim e çdo personi që do të ripranohet bazuar në paragrafin (1) të Nenit 2, të kësaj Marrëveshjeje, do të provohen nëpërmjet njërit prej dokumenteve të vlefshme të mëposhtme:

a) një dokument shtetëror identiteti (pavarësisht nëse është i momentit ose i përkohshëm), i cili duhet padyshim t'i përkasë atij personi; ose

b) një pasaportë ose një dokument udhëtimi zëvendësues me fotografi (lejekalimi) ku të tregohet Shtetësia dhe/ose zotërimi i të Drejtës për Qëndrim në një Palë Kontraktuese; ose

c) një dokument udhëtimi për Fëmijën në vend të pasaportës; ose

d) Regjistrat e shërbimit dhe fletëhyrje të ushtrisë.

2. Identiteti dhe Shtetësia ose e Drejta për Qëndrim mund të prezumohen në mënyrë të arsyeshme nga sa më poshtë:

a) një dokument, parashikuar në paragrafin (1) të këtij Neni, vlefshmëria e të cilit ka mbaruar, por që në mënyrë bindëse mund t'i përkasë personit:

b) ndonjë lloj dokumenti tjetër zyrtar, i cili ndihmon për identifikimin e personit në fjalë (p.sh.: një leje drejtimi);

c) prova të regjistruara në procesverbal sipas rregullave , rregullisht të dhëna nga dëshmitarë *bona fide* në prezencë të autoriteteve kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese;

d) shpjegime të regjistruara në procesverbal, të dhëna nga personi në fjalë për autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese;

e) gjuha e folur nga personi në fjalë;

f) një dokument identifikimi i kompanisë;

g) një përmbledhje e marrë nga të dhënat e regjistruara në Zyrat e Gjendjes Civile;

h) pasaporta e detarit;

i) dokument identifikimi i varkëtarit;

j) dokumente të tjera ku të ketë evidenca për identitetin e personit në fjalë;

k) fotokopje të dokumenteve të lartpërmendura,

si dhe ndonjë lloj prove të pranueshme nga të dyja Palët Kontraktuese, e cila mund të ndihmojë për të vërtetuar shtetësinë ose të drejtën për qëndrim të personit në fjalë.

Neni 4

Kërkesat për ripranim

1. Ndonjë kërkesë për ripranim, në bazë të Nenit 2, të kësaj Marrëveshjeje, do të bëhet me shkrim dhe do të përmbajë informacionin i cili është sqaruar në Nenin 1, të protokollit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kërkesa për ripranim do të dorëzohet tek autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese të kërkuar.

Neni 5

Përgjigjja për kërkesën

1. Përgjigjja për kërkesën për ripranim në bazë të Nenit 2, të kësaj Marrëveshjeje do të sigurohet nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese të kërkuar për autoritetin kompetent të Palës Kontraktuese kërkuese në bazë të procedurës dhe brenda afateve kohore të përcaktuara në Nenin 6, të Marrëveshjes.

2. Përgjigjja për kërkesën do të përmbajë informacionin i cili është përcaktuar në Nenin 2, të Protokollit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Afatet kohore

1. Me përjashtim të atyre kërkesave të parashtruara në evidencat e përcaktuara në paragrafin (1) të Nenit 3, të kësaj Marrëveshjeje, përgjigjet për kërkesat e ripranimit të bëra në bazë të Nenit 2, të kësaj Marrëveshje, do të jepen me shkrim brenda pesëmbëdhjetë ditësh pune nga data e dorëzimit të kërkesës. Çdo refuzim për ripranim duhet të jetë i argumentuar.

2. Në rast se një kërkesë për ripranim e bërë në bazë të Nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje bazohet në dokumentet e përcaktuara në paragrafin (1) të Nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje, një përgjigje do të jepet brenda dhjetë ditësh pune nga data e dorëzimit të kërkesës.

3. (a) Në rast se dokumentet e dorëzuara dhe faktet nuk janë të pamjaftueshme ose të kontestueshme, zyrtarët kompetentë konsullorë të Palës Kontraktuese të kërkuar mund t'i kërkojnë Palës Kontraktuese kërkuese të intervistojë personin në fjalë brenda një afati kohor më të shkurtër, dhe mund të jenë edhe vetë prezent në intervistën në fjalë.

3. (b) Për kohën dhe vendin e intervistës duhet të bihet dakord në mënyrë të përbashkët. Kërkesa për një intervistë të tillë do të paraqitet nga Pala Kontraktuese e kërkuar brenda afatit

kohor të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij Neni. Përgjigjja për kërkesën e ripranimit do të jepet me shkrim brenda dhjetë ditësh pune nga data e intervistës.

4. Pala Kontraktuese kërkuese do të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar largimin ose nisjen nga territori i shtetit të saj të personit, për ripranimin e të cilit është rënë dakord në përputhje me këtë Marrëveshje brenda tridhjetë ditësh pune nga data e marrjes së miratimit të Palës Kontraktuese të kërkuar. Ky afat kohor mund të zgjatet për aq kohë që është në mënyrë të arsyeshme e nevojshme që të zgjidhen pengesat ligjore ose praktike.

PJESA 2

RIPRANIMI I SHTETASVE TË PALËS SË TRETË

Neni 7

Shtetasit e palës së tretë me viza ose me leje qëndrimi

1. Siç ishte objekti i paragrafit (2) të këtij Neni, secila Palë Kontraktuese do të ripranojë me kërkesë të Palës tjetër Kontraktuese dhe pa formalitete të panevojshme çdo shtetas të palës së tretë, i cili nuk i plotëson, ose nuk i plotëson më, rregullat e hyrjes ose të qëndrimit në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese, me kusht që ai të ketë një vizë të vlefshme ose një leje qëndrimi të vlefshme të lëshuar nga Pala Kontraktuese e kërkuar dhe kur i plotëson kërkesat e legjislacionit të saj kombëtar për hyrje dhe për qëndrim për të huajt.

2. Pavarësisht nga përcaktimet e paragrafit (1) të këtij Neni, në rastet kur të dyja Palët Kontraktuese kanë lëshuar vizë ose leje qëndrimi, përgjegjësia i mbetet Palës Kontraktuese, viza ose leja e qëndrimit të së cilës skadon e fundit.

Neni 8

Shtetasit e palës së tretë të cilët kanë hyrë ose qëndruar në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar

1. Secila Palë Kontraktuese do të ripranojë në territorin e shtetit të saj me kërkesë të Palës tjetër Kontraktuese dhe pa formalitete të panevojshme, çdo shtetas të palës së tretë, i cili nuk plotëson, ose nuk i plotëson më, kushtet në fuqi për hyrje ose për qëndrim në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese Kërkuese me kusht që ajo është dokumentuar, në përputhje me paragrafin (1) të Nenit 9, të kësaj Marrëveshjeje, ose prezumohet në mënyrë të arsyeshme, në përputhje me paragrafin (2) të Nenit 9, që një shtetas i tillë i një pale të tretë kishte hyrë ose kishte qëndruar në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar.

2. Asnjë detyrim për ripranim nuk do të ekzistojë në bazë të klauzolave të paragrafit (1) të këtij Neni për:

a) Shtetas të palës së tretë për të cilët Pala Kontraktuese kërkuese ka pranuar statusin e refugjatit në bazë të konventës e cila ka të bëjë me Statusin e Refugjatit bërë në Gjenevë, më 28 korrik 1951[1] dhe me protokollin bërë në Nju-Jork, më 31 janar 1967[2], duke plotësuar konventën e përmendur ose statusin e personave pa shtetësi, siç është përcaktuar nga

konventa që ka të bëjë me statusin e personave pa shtetësi, bërë në Nju-Jork, më 28 shtator 1954[3] ;

b) Shtetas të palës së tretë, shteti i shtetësisë së të cilëve ka një kufi të përbashkët me territorin e shtetit të Palës Kontraktuese Kërkuese, si edhe shtetas të tjerë të palës së tretë me qëndrim të përhershëm në territorin e një shteti të tillë të palës së tretë;

c) Shtetas të palës së tretë të cilët Pala Kontraktuese e kërkuar i ka kthyer më parë në vendet e tyre të origjinës ose në ndonjë shtet tjetër të palës së tretë, tek i cili hyrja e tyre është siguruar;

d) Shtetas të palës së tretë të cilët kanë leje për të kaluar tranzit nga Pala Kontraktuese e kërkuar, bazuar në një vizë të vlefshme ose në një leje qëndrimi të vlefshme, të lëshuara nga një shtet pasues tranziti ose destinacioni;

e) Shtetas të palës së tretë të cilët kanë leje për të kaluar tranzit nga Pala Kontraktuese e kërkuar në rastet kur atyre nuk u duhet vizë ose leje qëndrimi për të hyrë ose për të qëndruar në një shtet pasues tranziti ose destinacioni;

f) Shtetas të palës së tretë të cilët pasi janë larguar nga territori i shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar, fillimisht kanë hyrë ose qëndruar në territorin e shtetit të një pale të tretë, përveç atyre personave të cilët kanë kaluar përmes zonës së tranzitit, në mënyrë që të arrijnë në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese;

g) Shtetas të palës së tretë të cilët kanë mbajtur një leje qëndrimi të vlefshme, të lëshuar nga Pala Kontraktuese kërkuese për një periudhë prej më shumë se gjashtë muajsh. Për të shmangur ndonjë dyshim, një leje qëndrimi e përjashton një vizë dhe ndonjë autorizim të përkohshëm për qëndrim lëshuar gjatë shqyrtimit të një aplikimi për leje qëndrimi ose për azil.

Neni 9

Prezumimi i hyrjes ose i qëndrimit

1. Hyrja ose qëndrimi i shtetasve të palës së tretë në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar do të dokumentohet nga vendosja e vulave të kufirit ose nga shenja të tjera të përshtatshme të vendosura në dokumentet e tyre të udhëtimit nga autoritetet e kontrollit të kufirit të Palës Kontraktuese të kërkuar, në hyrje ose në dalje nga territori i shtetit të saj.

2. Hyrja ose qëndrimi i shtetasve të palës së tretë në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar mund të prezumohet në mënyrë të arsyeshme në bazë të:

a) dokumenteve të transportit;

b) provës së pagesës për hotel, shërbime mjekësore ose shërbime të tjera etj.;

c) evidenca të protokolluara të paraqitura nga dëshmitarë *bona fide*, të dorëzuara tek autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese;

d) evidenca të protokolluara të dhëna nga shtetasi i palës së tretë për autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese.

Neni 10

Kërkesa për ripranimin e shtetasve të palës së tretë

1. Një kërkesë për ripranim të shtetasve të palës së tretë në bazë të Nenit 7 ose 8 të kësaj Marrëveshjeje, do të dorëzohet me shkrim dhe do të përmbajë informacionin i cili është përcaktuar në Nenin 4, të protokollit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kërkesa për ripranim në bazë të paragrafit (1) të Nenit 7 dhe paragrafit (1) të Nenit 8, të kësaj Marrëveshjeje do t'i dorëzohet autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese të kërkuar.

3. Përgjigjja për kërkesën për ripranimin e bërë në bazë të Nenit 7 ose 8, të kësaj Marrëveshjeje do të jepet me shkrim, brenda pesëmbëdhjetë ditësh pune nga data e marrjes së saj. Çdo refuzim për ripranim duhet të jetë i argumentuar.

4. Pala Kontraktuese kërkuese do të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar largimin ose nisjen nga territori i shtetit të saj të personit, për ripranimin e të cilit është rënë dakord, në përputhje me këtë marrëveshje, brenda tridhjetë ditësh pune nga data e marrjes së miratimin të Palës Kontraktuese të kërkuar. Ky afat kohor mund të zgjatet për aq kohë sa është në mënyrë të arsyeshme e nevojshme që të zgjidhen pengesat ligjore ose praktike.

Neni 11

Përgjigjja për kërkesën

1. Përgjigjja për kërkesën për ripranim në bazë të Nenit 7 ose 8, të kësaj Marrëveshjeje do të sigurohet nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese të kërkuar për autoritetin kompetent të Palës Kontraktuese kërkuese në bazë të procedurës dhe brenda afateve kohore të përcaktuara në Nenin 10 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Përgjigjja për kërkesën do të përmbajë informacionin e përcaktuar në Nenin 5 të protokollit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Detyrimi për të ripranuar

1. Secila Palë Kontraktuese do të ripranojë me kërkesë të Palës tjetër Kontraktuese dhe pa ndonjë formalitet të veçantë, çdo shtetas të palës së tretë, i cili është nisur ose larguar nga territori i shtetit të saj, në përputhje me klauzolat e paragrafit (1) të Nenit 7, të kësaj Marrëveshjeje, kur nga verifikimet e mëvonshme rezulton se personi i ripranuar, në kohën e largimit nga territori i shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese nuk kishte një vizë të vlefshme ose një leje qëndrimi të vlefshëm, e cila i jepte të drejtën të hynte dhe të qëndronte në shtetin e Palës Kontraktuese të kërkuar, në përputhje me Nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në rastet kur klauzolat e paragrafit (1) të këtij Neni aplikohen, Pala Kontraktuese e cila në fillim ka ripranuar persona të tillë, do të informojë Palën tjetër Kontraktuese për arsyet për refuzimin e tyre dhe do të kthejë të gjitha dokumentet e marra në lidhje me procedure fillestare të ripranimit.

3. Secila Palë Kontraktuese do të ripranojë me kërkesë të Palës tjetër Kontraktuese dhe pa ndonjë formalitet të veçantë, ndonjë shtetas të palës së tretë, i cili është nisur ose është larguar nga territori i shtetit të saj, konform klauzolave të paragrafit (1) të Nenit 8 të kësaj Marrëveshjeje, kur nga verifikimet e mëvonshme rezulton se personi i ripranuar, në kohën e largimit nga territori i Shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese, në fakt nuk kishte hyrë ose qëndruar në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese, të kërkuar në përputhje me Nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje.

4. Në rastet kur klauzolat e paragrafit (3) të këtij Neni aplikohen, Pala Kontraktuese e cila fillimisht i ka ripranuar persona të tillë, do të informojë Palën tjetër Kontraktruese për arsyet për refuzimin e tyre dhe do të kthejë të gjitha dokumentet e marra në lidhje me procedurën fillestare të ripranimit

PJESA 3

TRANZITI

Neni 13

Detyrimi për të lejuar tranzitin

1. Secila Palë Kontraktuese do të lejojë me kërkesë të Palës tjetër Kontraktuese, tranzitin nëpërmjet territorit të shtetit të saj për shtetasit e Palës së tretë të larguar nga Pala Kontraktuese kërkuese për qëllim të ripranimit për në vendet e tyre të origjinës ose për te shtetet e palës së tretë nëse:

a) pranimi në ndonjë shtet tjetër tranziti dhe në shtetin e destinacionit është i siguruar; dhe

b) Pala Kontraktuese kërkuese merr për shtetasin e palës së tretë ndonjë leje tranziti të kërkuar, në përputhje me paragrafin (2) të Nenit 13.

2. Pala Kontraktuese e kërkuar mund të kërkojë që Pala Kontraktuese kërkuese të sigurojë, përpara largimit të ndonjë shtetasi të palës së tretë nga territori i shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese, ndonjë leje tranziti e kërkuar nga ligjet ose rregulloret që aplikohen herë pas here në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar përpara tranzitit, nëpërmjet territorit të shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar për një shtetas të tillë të palës së tretë.

3. Pala Kontraktuese kërkuese do të ketë përgjegjësi të plotë për tranzitin e personave të tillë për në vendin e destinacionit përfundimtar dhe do të jetë përgjegjëse për largimin e atyre personave nga territori i shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar në rastet kur udhëtimi mëtejshëm nuk mund të vazhdojë.

4. Pala Kontraktuese e kërkuar mund të kërkojë që një përfaqësues i autoriteteve kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese të sigurojë eskortimin e një tranziti të tillë për shtetasit e Palës së tretë gjatë tranzitit nëpërmjet territorit të Palës Kontraktuese të kërkuar.

5. Pavarësisht nga ndonjë autorizim i lëshuar, persona të marrë në ngarkim për qëllime tranziti do të ripranohen nga Pala Kontraktuese kërkuese pa formalitet, nëse rrethanat brenda kuptimit të Nenit 21, të kësaj Marrëveshjeje më vonë ngrihen ose dalin në pah, të cilat pengojnë një operacion tranziti ose në rast se udhëtimi i mëtejshëm ose pranimi nga shteti i destinacionit nuk sigurohet më.

6. Palët Kontraktuese do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për t'iu përmbajtur operacioneve të tranzitit për shtetasit e palës së tretë, të cilët nuk mund të kthehen në shtetin e tyre të destinacionit në mënyrë direkte.

Neni 14

Kërkesat për tranzit

1. Çdo kërkesë për të lejuar tranzitin në bazë të Nenit 13, të kësaj Marrëveshjeje do të bëhet me shkrim dhe do të përmbajë informacionin i cili është përshkruar në Nenin 6, të protokollit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kërkesat për të lejuar tranzitin do të dërgohen direkt midis autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese.

3. Kërkesa do të firmoset dhe vuloset nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese kërkuese.

Neni 15

Përgjigjja për kërkesën

1. Përgjigjja për kërkesën për të lejuar tranzitin në bazë të Nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje do të sigurohet nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese të kërkuar për autoritetin kompetent të Palës Kontraktuese kërkuese me shkrim brenda pesëmbëdhjetë ditësh pune nga data e dorëzimit të kërkesës. Çdo refuzim i një kërkese për të lejuar tranzitin do të jetë i argumentuar.

2. Përgjigjja për kërkesën do të përmbajë informacionin i cili është përshkruar në Nenin 7, të protokollit të kësaj Marrëveshjeje.

3. Në përputhje me paragrafin (2) të Nenit 13, në rastet kur pranohet një kërkesë për të lejuar tranzitin, Pala Kontraktuese e kërkuar mund të deklarojë që pranimi nga ana e saj është i kushtëzuar nga leja për të kaluar tranzit, e cila sigurohet nga shtetasi i palës së tretë përpara largimit nga territori i shtetit të Palës Kontraktuese me qëllim tranzitin nëpërmjet territorit të shtetit të saj.

Neni 16

Refuzimi i kërkesës

Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, një kërkesë për tranzit në bazë të Nenit 13, të kësaj Marrëveshjeje mund të refuzohet kur:

a) prezenca e shtetasit të palës së tretë në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar

mund të mos jetë në ndihmë të interesave të sigurisë kombëtare, të rendit publik ose të shëndetit publik; ose

b) shtetasi i palës së tretë nuk ka ndonjë leje për të kaluar tranzit, leja e cila kërkohet nga Pala Kontraktuese e kërkuar, në përputhje me paragrafin (2) të Nenit 13; ose

c) shtetasi i palës së tretë është refuzuar për t'i dhënë ndonjë leje tranziti, leje e cila kërkohet nga Pala Kontraktuese e kërkuar, në përputhje me paragrafin (2) të Nenit 13.

PJESA 4

KLAUZOLAT E PËRGJITHSHME DHE MBYLLËSE

Neni 17

Komiteti i ekspertëve

1. Palët Kontraktuese do t'i sigurojnë njëra-tjetrës asistencë të përbashkët gjatë aplikimit dhe interpretimit të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë ato do të krijojnë një Komitet Ekspertësh, e parashikuar kjo në Nenin 12, të protokollit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Palët Kontraktuese rezervojnë të drejtën të pranojnë ose jo propozimet dhe masat e sugjeruara nga Komiteti i Ekspertëve.

Neni 18

Eskortimi

1. (a) Pala Kontraktuese kërkuese, sa herë të jetë në mënyrë të arsyeshme e praktikueshme, do të informojë Palën Kontraktuese të kërkuar mbi nevojën për të eskortuar persona, për ripranimin ose tranzitimin e të cilëve është rënë dakord në kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

1. (b) Kur shërbimet e eskortimit sigurohen nga, ose nën drejtimin e, Pala Kontraktuese kërkuese, oficerëve të eskortës do t'u kërkohet që të kenë ndonjë autorizim, vizë ose leje për të kaluar tranzit e kërkuar nga Pala Kontraktuese e kërkuar, me qëllim që të kryhen shërbime të tilla eskortimi, përpara largimit nga territori i Palës Kontraktuese kërkuese.

2. Kur tranziti kryhet nëpërmjet transferimit me aeroport në territorin e Palës Kontraktuese të kërkuar ose nëpërmjet pikave të hyrjes për në territorin e saj, masa eskortimi do të merren, në rastet kur është e përshtatshme, nga Pala Kontraktuese kërkuese dhe Pala Kontraktuese e kërkuar do të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar se personi i cili do të kalojë tranzit nuk do të lejohet të largohet nga zona e tranzitit të aeroportit të Palës Kontraktuese të kërkuar.

3. Kur kryhen rastet e largimit për qëllime ripranimi ose tranziti, masat e eskortimit do të merren kur është e përshtatshme nga Pala Kontraktuese kërkuese.

Neni 19

Shpenzimet e kthimit

1. Shpenzimet në lidhje me ripranimin e personave, përfshirë ato të eskortimit, jetesës dhe transportimit të përshtatshëm, në përputhje me nenet 2, 7 dhe 8, të kësaj Marrëveshjeje, do të mbulohen nga Pala Kontraktuese kërkuese.

2. Shpenzimet e tranzitit, në përputhje me Nenin 13, të kësaj Marrëveshjeje, deri në kufirin e shtetit të destinacionit, dhe në rastet kur është e nevojshme, shpenzimet që rrjedhin nga transporti i kthimit, në të dyja rastet, përfshirë shpenzimet e eskortimit, jetesës dhe të transportimit, do të mbulohen nga Pala Kontraktuese kërkuese.

Neni 20

Njoftimi

Përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike në lidhje me:

a) pikat e kontrollit të kufirit të cilat mund të përdoren për qëllime ripranimi dhe kalime të tranzitit;

b) autoritetet kompetente për t'u marrë me kërkesat për ripranim dhe tranzit në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 21

Marrëveshje të tjera që nuk preken dhe përjashtime

1) Klauzolat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të prekin të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese që rrjedhin nga:

a) marrëveshjet e tjera ndërkombëtare mbi ekstradimin, transferimin e personave të dënuar, asistencën e përbashkët ligjore në çështjet kriminale dhe ripranimin ose aktin e tranzitimit në rastet e largimit të personave në përgjithësi;

b) Konventa në lidhje me Statusin e Refugjatit, bërë në Gjenevë, më 28 korrik 1951, sikurse është amenduar nga protokolli bërë në Nju-Jork më 31 janar 1967;

c) çdo marrëveshje ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut;

d) marrëveshjet ndërkombëtare mbi azilin

e) çdo marrëveshje tjetër ndërkombëtare.

2) Në lidhje me:

a) një person për të cilin Pala Kontraktuese ka detyrim ta ripranojë, në bazë të paragrafit (1) të Nenit 2, të kësaj Marrëveshjeje dhe

b) një shtetas të palës së tretë, i cili ka hyrë direkt nga territori i shtetit të njërës prej Palëve Kontraktuese në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese (dhe një person do të konsiderohet sikur ka hyrë direkt në rast se ai ka kaluar tranzit nëpërmjet një shteti të palës së tretë për qëllim të hyrjes në Palën tjetër Kontraktuese pa u larguar nga ndonjë zonë tranziti të portit ose aeroportit dhe pa kaluar nëpërmjet pikës së kontrollit të imigracionit);

Klauzolat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të veprojnë në mënyrë që të paragjykojnë rregullime të tjera të cilat aplikohen herë pas here në territorin e Palës Kontraktuese, me anë të të cilave një person mund të dëbohet ose përndryshe largohet nga territori i njërës prej Palëve Kontraktuese.

Neni 22

Modalitetet e zbatimit

Të gjitha klauzolat e mëtejshme për zbatimin janë përcaktuar në protokollin e kësaj Marrëveshjeje, e cila është një pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 23

Aplikimi territorial

Kjo Marrëveshje zbatohet

1. Në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar:

a. në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut;

b. në territorin e Gjibraltarit; dhe

c. në çdo territor për marrëdhëniet ndërkombëtare për të cilat Mbretëria e Bashkuar është përgjegjëse dhe në të cilin do të shtrihej kjo Marrëveshje me shkëmbim notash. Një shtrirje e tillë mund të përfundohet nga secila Palë Kontraktuese duke i paraqitur një njoftim me shkrim gjashtë muaj përpara, Palës tjetër Kontraktuese, nëpërmjet kanalit diplomatik.

2. për Republikën e Shqipërisë.

Neni 24

Hyrja në fuqi

1. Secila Palë Kontraktuese njofton palën tjetër me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për plotësimin e procedurave ligjore të brendshme që kërkohen nga legjislacioni për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në:

(a) datën e njoftimit më të fundit të Palëve Kontraktuese për plotësimin e procedurave ligjore të brendshme nga ana e tyre.

Neni 25

Kohëzgjatja, ndryshimi, pezullimi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore.

2. Secila Palë Kontraktuese mund ta pezullojë këtë Marrëveshje duke i dhënë tjetrës një njoftim me shkrim. Pezullimi do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas marrjes së njoftimit me shkrim nga Pala tjetër Kontraktuese ose në ndonjë datë të mëvonshme të specifikuar në njoftim.

3. Secila Palë Kotraktuese mund të ndërpresë këtë Marrëveshje duke njoftuar palën tjetër në formë të shkruar kur gjykon se ka baza të arsyeshme për ta bërë këtë.

i) Kjo ndërprerje hyn në fuqi ditën e trembëdhjetë pas marrjes së njoftimit me shkrim nga Pala tjetër Kontraktuese ose në një datë të mëvonshme, siç përcaktohet në njoftim.

ii) Palët Kontraktuese mund të bien dakord të anulojnë ndërprerjen e marrëveshjes në çdo kohë pas dërgimit të një lajmërimi deri në ditën kur ndërprerja hyn në fuqi.

iii) Kur Marrëveshja është ndërprerë dhe Pala Kontraktuese anuluese dëshiron ta revokojë ndërprerjen, ajo njofton me shkrim Palën tjetër Kontraktuese pa vonesa nëpërmjet kanaleve diplomatike, Ndërprerja revokohet në ditën e trembëdhjetë pas marrjes së njoftimit nga Pala tjetër Kontraktuese, ose në të kundërt në datën e dakordësuar nga Palët Kontraktuese.

4. Palët Kontraktuese mund të bien dakord me shkrim ta ndryshojnë këtë marrëveshje. Ndryshimi hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimeve më të fundit të Palëve Kontraktuese se janë plotësuar procedurat e brendshme nga ana e tyre, ose në datën e dakordësuar nga Palët Kontraktuese.

Të poshtëshënuarit duke qenë dëshmitarë dhe duke pasur autorizimin e duhur nga qeveritë e tyre përkatëse, firmosën këtë Marrëveshje.

Nënshkruar në , më , në 2 (dy) origjinale, në gjuhën shqipe dhe angleze. Në rast mospërputhjesh në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:	Për Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut
Ministri Brend h m	Ministri i Brendshëm
Bledar Çuçi	Priti Patel

PROTOKOLLI PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT MBI RIPRANIMIN E PERSONAVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe (më poshtë quajtur "Palët Kontraktuese");

Me dëshirën për të përcaktuar masa për zbatimin e Marrëveshjes së nënshkruar në _____ më _____, në lidhje me Ripranimin e Personave më poshtë quajtur "Marrëveshja";

Ranë dakord si më poshtë:

NENI I

Kërkesa për ripranim të personave sipas Nenit 2 të Marrëveshjes

(1) Çdo kërkesë për ripranim sipas Nenit 2, të marrëveshjes do të bëhet me shkrim dhe do të përmbajë:

(a) Emrin dhe adresën e Autoritetit Kompetent të Palës Kontraktuese Kërkuese, numrin e dosjes dhe datën e kërkesës;

(b) Emrin dhe adresën e Palës Kontraktuese të Kërkuar;

(c) Një tekst hyrës, si vijon: "Ka arsye për të besuar se personi i identifikuar më poshtë është i mbuluar nga dispozitat e Nenit 2, të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi ripranimin e personave dhe ne kërkojmë që ky person të pranohet në territorin e (Republikës së Shqipërisë) (Mbretërisë së Bashkuar) në përputhje me dispozitat e asaj Marrëveshjeje."

(2) Me çdo kërkesë për ripranim do sigurohet sa më poshtë:

(a) Të dhënat personale

(i) mbiemri dhe emra të tjerë;

(ii) data e lindjes;

(iii) vendi dhe shteti i lindjes;

(iv) gjinia;

(v) vetëm për fëmijët, mbiemri dhe emrat e tjerë të ndonjë lidhjeje për të cilën Pala Kontraktuese kërkuese është në dijeni.

(b) Kopjet të noterizuara të dokumenteve origjinale që përbëjnë mjete provë ose mjete për ngritjen e një prezumimi të Shtetësisë ose të Drejtës së Qëndrimit të personit që do të kthehet:

(i) Dokumentet e shtetësisë ose të identitetit shtetëror: numri, data dhe vendi i lëshimit, autoriteti lëshues; ose

(ii) pasaporta: lloji dhe numri, data e lëshimit, autoriteti lëshues dhe vendi i lëshimit; ose

(iii) çdo dokument tjetër udhëtimi që tregon Shtetësinë: emri i dokumentit, numri, data dhe vendi i lëshimit dhe autoriteti lëshues; ose

(iv) dokumente të tjerë që sigurojnë një mjet për ngritjen e një prezumimi që do të pranohet nga Pala Kontraktuese e kërkuar siç parashikohet në paragrafin (2) të Nenit 3, të Marrëveshjes, p.sh. leje drejtimi, certifikatë lindjeje etj.

(c) 2 fotografi të formatit të pasaportës.

(d) Një listë e mjeteve të provës dhe/ose mjeteve për ngritjen e një prezumimi që është dhënë në përputhje me Marrëveshjen.

(e) Itinerar i planifikuar, mjetet e transportit, data dhe koha e ripranimit të planifikuar, pikat e hyrjes në kufi.

(f) Udhëzime në lidhje me domosdoshmërinë e policisë ose eskortës tjetër dhe/ose mbikëqyrjes mjekësore kur është e arsyeshme e mundur; dhe nëse shoqërimi do të sigurohet nga Autoritetet Kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese, të dhënat e oficerëve që shoqërojnë personin.

(g) Deklarata që personi në fjalë përputhet me kërkesat e Nenit 2, të Marrëveshjes.

(h) Nënshkrimi dhe vula e Autoriteteve Kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese.

(3) Do të sigurohet edhe sa vijon kudo që është e mundur:

(a) Të dhënat personale

(i) emri i plotë i babait dhe/ose nënës;

(ii) emrat e mëparshëm;

(iii) pseudonimi ose aliasi;

(iv) adresa e fundit në territorin e Shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar;

(v) të dhëna në lidhje me shëndetin, dhe në latinisht emrin e çdo sëmundje ngjitëse nga e cila mund të vuajë personi që do të kthehet.

(b) Në lidhje me fëmijët, kopje e certifikatës së lindjes.

NENI II

Përgjigja e kërkesës për ripranim të personave sipas nenit 2 të marrëveshjes

(1) Përgjigja ndaj kërkesës për ripranim sipas Nenit 2, të Marrëveshjes do të sigurohet nga Autoriteti Kompetent i Palës Kontraktuese të kërkuar Autoritetit Kompetent të Palës Kontraktuese kërkuese në përputhje me procedurën dhe brenda afateve të përcaktuara në Nenin 6, të Marrëveshjes.

(2) Përgjigja ndaj kërkesës duhet të përmbajë:

(a) emrin dhe adresën e Autoritetit Kompetent të Palës Kontraktuese të kërkuar, numrin e dosjes dhe datën e përgjigjes së kërkesës;

(b) emrin dhe adresën e Autoritetit Kompetent të Palës Kontraktuese kërkuese;

(c) mbiemrin dhe emra të tjerë të personit që do të kthehet, data e lindjes, vendi i lindjes dhe shteti i lindjes aty ku është në dispozicion; dhe

(d) ose (i) në rastin e një përgjigje pozitive, konfirmimi se personi që do të kthehet përfshihet nga dispozitat e Nenit 2, të Marrëveshjes; ose (ii) në rast të një përgjigje negative, arsyet pse personi nuk përfshihet nën dispozitat e Nenit 2, të Marrëveshjes.

NENI III

Dokumenti i udhëtimit

(1) Autoritetet Kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese do t'i dërgojnë përfaqësimit diplomatik ose konsullor të Palës Kontraktuese të kërkuar përgjigjen pozitive të kërkesës me qëllim të lëshimit të një dokumenti udhëtimi, kur kjo është e nevojshme. Përfaqësimi diplomatik-konsullor i Palës Kontraktuese të kërkuar, në bazë të përgjigjes pozitive të kërkesës, lëshon një dokument udhëtimi brenda tre ditësh pune, kur është e mundur, dhe në çdo rast jo më vonë se pesë ditësh pune, pas përgjigjes pozitive për personin kthimi i të cilit është pranuar.

(2) Dokumenti i udhëtimit do të jetë i vlefshëm për përdorim për një periudhë jo më shumë se tridhjetë ditë nga data e marrjes nga Pala Kontraktuese kërkuese, ose periudhë tjetër që mund

të bihet dakord në përputhje me paragrafin (4) të Nenit 6, ose paragrafit (4) të Nenit 10, të marrëveshjes.

NENI IV

Kërkesë për ripranim të shtetasve të Palës së Tretë

(1) Çdo kërkesë për ripranim sipas neneve 7 ose 8, të Marrëveshjes do të bëhet me shkrim dhe do të përmbajë:

(a) Emrin dhe adresën e Autoritetit Kompetent të Palës Kontraktuese kërkuese, numrin e dosjes dhe datën e kërkesës;

(b) Emrin dhe adresën e Palës Kontraktuese të kërkuar;

(c) Një tekst hyrës, si më poshtë: "Ka arsye për të besuar se personi i identifikuar më poshtë është i mbuluar nga dispozitat e Nenit 7, (ose 8 sipas rastit) të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë mbi ripranimin e personave dhe ne kërkojmë që ky person të pranohet në territorin e (Mbretërisë së Bashkuar) (Republikës së Shqipërisë) në përputhje me dispozitat e asaj Marrëveshjeje."

(2) Në vijim do të sigurohet çdo kërkesë për ripranim:

(a) Të dhënat personale

(i) mbiemri dhe emrat e tjerë;

(ii) data e lindjes;

(iii) vendi dhe shteti i lindjes;

(iv) gjinia;

(v) vetëm për fëmijët, mbiemri i familjes dhe emri(at) e tjerë të ndonjë lidhjeje për të cilën Pala Kontraktuese kërkuese ka dijeni.

(b) Kopjet e dokumenteve origjinale që përbëjnë mjete provë, ose mjete për krijimin e një prezumimi, të posedimit të një Vize të vlefshme ose Leje Qëndrimi të vlefshme të lëshuar nga Autoritetet Kompetente të Palës Kontraktuese të kërkuar dhe kualifikimin për të hyrë dhe banuar në legjislacionin kombëtar të asaj Pale Kontraktuese të personit që do të kthehet si më poshtë:

(i) Dokumentet e shtetësisë ose të identitetit shtetëror përfshirë dokumentin e vlefshëm të korrespondencës së Vizave: numri, data dhe vendi i lëshimit, autoriteti lëshues; ose

(ii) pasaporta përfshirë Vizën ose Lejen e Qëndrimit të vlefshme: lloji dhe numri, data e lëshimit, autoriteti lëshues dhe vendi i lëshimit; ose

(iii) çdo dokument tjetër udhëtimi që tregon Shtetësinë dhe përfshin Vizën ose Lejen e vlefshme të qëndrimit: emrin e dokumentit, numrin, datën dhe vendin e lëshimit dhe autoritetin lëshues; ose

(iv) Kopjet e noterizuara të dokumenteve origjinale që përbëjnë mjete prove, ose mjete për vendosjen e një prezumimi të hyrjes ose qëndrimit në territorin e Palës Kontraktuese të kërkuar siç përcaktohet në Nenin 9, të Marrëveshjes.

(c) 2 fotografi në formatin e pasaportës.

(d) Një listë e mjeteve të provës dhe/ose mjeteve për krijimin e një prezumimi që është dhënë në përputhje me Marrëveshjen.

(e) Itinerari i planifikuar, mjetet e transportit, data dhe koha e ripranimit të planifikuar, pikat e hyrjes në kufi.

(f) Udhëzime në lidhje me domosdoshmërinë e policisë ose të një eskorte tjetër dhe/ose mbikëqyrjes mjekësore kur është e arsyeshme e mundur; dhe nëse shoqërimi do të sigurohet nga Autoritetet Kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese, të dhënat e oficerëve që shoqërojnë personin.

(g) Deklarata që personi në fjalë përputhet me kërkesat e Nenit 7, (ose 8 sipas rastit) të Marrëveshjes.

(h) Nënshkrimi dhe vula e Autoriteteve Kompetente të Palës Kontraktuese Kërkuese.

(3) Më poshtë do të sigurohet gjithashtu kur është e arsyeshme në dispozicion:

(a) Të dhëna Personale

(i) emri i plotë i babait dhe/ose nënës;

(ii) emrat e mëparshëm

(iii) pseudonimi ose aliasi

(iv) adresa e fundit në territorin e Shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar

(v) të dhëna në lidhje me shëndetin, dhe në latinisht emrin e çdo sëmundje ngjitëse nga e cila personi që do të kthehet mund të vuajë.

(b) Në lidhje me fëmijët, kopja e noterizuar e certifikatës së lindjes.

NENI V

Përgjigjja e kërkesës për ripranim të shtetasve të palëve të treta

(1) Përgjigjja ndaj kërkesës për ripranim sipas Nenit 7, (ose 8 sipas rastit) të Marrëveshjes do të sigurohet nga Autoriteti Kompetent i Palës Kontraktuese të Kërkuar Autoritetit Kompetent të Palës Kontraktuese Kërkuese në përputhje me procedurën dhe brenda afateve të përcaktuara në Nenin 10, të Marrëveshjes.

(2) Përgjigja ndaj kërkesës duhet të përmbajë:

(a) emrin dhe adresën e Autoritetit Kompetent të Palës Kontraktuese të kërkuar, numrin e dosjes dhe datën e përgjigjes së kërkesës

(b) emrin dhe adresën e Autoritetit Kompetent të Palës Kontraktuese kërkuese

(c) ernrin e familjes dhe emrin(at) e tjerë të personit që do të kthehet, data e lindjes, vendi i lindjes dhe shtetin e lindjes kur është i disponueshëm dhe

(d) ose (i) në rastin e një përgjigje pozitive, konfirmimi se personi që do të kthehet përfshihet nën dispozitat e Nenit 7, (ose 8 sipas rastit) të Marrëveshjes; ose, (ii) në rast të një përgjigje negative, arsyet pse personi nuk përfshihet nën dispozitat e Nenit 7, (ose 8 sipas rastit) të Marrëveshjes.

NENI VI

Kërkesa për të lejuar tranzitin

(1) Çdo kërkesë për të lejuar tranzitin sipas Nenit 13 të Marrëveshjes do të bëhet me shkrim dhe do të përmbajë:

(a) Emrin dhe adresën e Autoritetit Kompetent të Palës Kontraktuese kërkuese, numrin e dosjes dhe datën e kërkesës;

(b) Emrin dhe adresën e Palës Kontraktuese të kërkuar

(c) Një tekst hyrës, si vijon: "Ka arsye për të besuar se personi i identifikuar më poshtë është i mbuluar nga dispozitat e Nenit 13 të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisëmbi ripranimin e personave dhe ne kërkojmë që tranziti i këtij personi përmes territorit të (Mbretërisë së Bashkuar) (Republika e Shqipërisë) të lejohet në përputhje me dispozitat e asaj Marrëveshjeje."

(2) Më poshtë do të sigurohet çdo kërkesë për leje për tranzit:

(a) Të dhëna Personale

(i) emri i familjes dhe emrat e tjerë

(ii) data e lindjes

(iii) vendi dhe shteti i lindjes

(iv) gjinia

(v) vetëm për fëmijët, emri i familjes dhe emri(at) e tjerë të çfarëdo lidhjeje për të cilën Pala Kontraktuese Kërkuese ka dijeni.

(b) Kopjet e certifikuara të dokumenteve origjinale që përbëjnë mjete prove, ose mjete për krijimin e një prezumimi se pranimi i shtetasit të Palës së Tretë në çdo shtet tjetër tranzit dhe shtetin e destinacionit është i siguruar.

(c) 2 fotografi në formatin e pasaportës

(d) Një listë e mjeteve të provës dhe/ose mjeteve për krijimin e një prezumimi që është dhënë në përputhje me Marrëveshjen

(e) Itinerari i planifikuar, mjetet e transportit, data dhe koha e ripranimit të planifikuar, pikat e hyrjes në kufi.

(f) Udhëzime në lidhje me domosdoshmërinë e policisë ose eskortimit tjetër dhe/ose mbikëqyrjes mjekësore kur është e arsyeshme e mundur; dhe nëse shoqërimi do të sigurohet nga Autoritetet Kompetente të Palës Kontraktuese Kërkuese, të dhënat e oficerëve që shoqërojnë personin.

(g) Deklarata se personi në fjalë përputhet me kërkesat e Nenit 13, të Marrëveshjes.

(h) Nënshkrimi dhe vula e Autoriteteve Kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese.

(3) Më poshtë do të sigurohet gjithashtu kur është e arsyeshme në dispozicion:

(a) Të dhëna Personale

(i) emrin e plotë të babait dhe/ose nënës

(ii) emrat e mëparshëm

(iii) pseudonim ose alias
(iv) adresa e fundit në territorin e Shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar
(v) të dhëna në lidhje me shëndetin, dhe në latinisht emrin e çdo sëmundje ngjitëse nga e cila personi që do të kthehet mund të vuajë

(b) Në lidhje me fëmijët, kopja e noterizuar e certifikatës së lindjes

NENI VII

Përgjigjja e kërkesës për të lejuar tranzitin

(1) Përgjigja ndaj kërkesës për të lejuar tranzitin sipas Nenit 13, të Marrëveshjes do të sigurohet nga Autoriteti Kompetent i Palës Kontraktuese të kërkuar Autoritetit Kompetent të

Palës Kontraktuese kërkuese në përputhje me procedurën dhe brenda afateve të përcaktuara në Nenin 15, të Marrëveshjes.

(2) Përgjigja ndaj kërkesës duhet të përmbajë:

(a) emrin dhe adresën e Autoritetit Kompetent të Palës Kontraktuese të kërkuar, numrin e dosjes dhe datën e përgjigjes së kërkesës

(b) emrin dhe adresën e Autoritetit Kompetent të Palës Kontraktuese kërkuese

(c) emrin e familjes dhe emrin(at) tjetër të personit që do të kthehet, data e lindjes, vendi i lindjes dhe shteti i lindjes kur është i disponueshëm; dhe ose (i) në rastin e një përgjigje pozitive, konfirmimi se personi që do të kalojë tranzit përmes territorit të Palës Kontraktuese të Kërkuar përfshihet nën dispozitat e Nenit 13, të Marrëveshjes (duke specifikuar nëse është e përshtatshme që kjo të kushtëzohet nga një Leje për të kaluar tranzit, që merret nga një shtetas i palës së tretë përpara nisjes nga territori i palës kërkuese kontraktuese në mënyrë që të kalojë nëpër territorin e saj në përputhje me paragrafin (3) të Nenit 15 të marrëveshjes); ose, (ii) në rast të një përgjigje negative, arsyet pse shtetasi i Palës së Tretë nuk përfshihet nën dispozitat e Nenit 13, të Marrëveshjes.

NENI VIII

Procedura e marrjes në dorëzim

(1) Autoriteti Kompetent i Palës Kontraktuese kërkuese do të njoftojë Autoritetin Kompetent të Palës Kontraktuese të kërkuar për largimin ose nisjen e personit që do të kthehet, ose kalimit tranzit përmes territorit të Palës Kontraktuese të Kërkuar, të paktën pesë ditë pune përpara largimit ose nisjes së planifikuar.

(2) Ky njoftim do të jetë me shkrim dhe do të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

(a) emrin dhe adresën e Autoritetit Kompetent të Palës Kontraktuese kërkuese, numrin e dosjes dhe datën e njoftimit

(b) emrin dhe adresën e Autoritetit Kompetent të Palës Kontraktuese të Kërkuar

(c) një tekst hyrës, si vijon: "Ne ju njoftojmë se në (ditë, muaj dhe vit) nga aeroporti ( ) me fluturimin nr. ( ), koha e nisjes ( ) dhe mbërritja në aeroport ( ) në ( ), personi i identifikuar më poshtë do të kthehet në (Mbretërinë e Bashkuar) (Republikën e Shqipërisë)"; ose "Ne ju njoftojmë që në (ditë, muaj dhe vit) nga aeroporti ( ) me nr. fluturimi ( ), ora e nisjes ( ), dhe mbërrin në aeroportin e ( ), në orën, personi i identifikuar më poshtë do të kalojë tranzit përmes (Mbretërisë së Bashkuar) (Republikës së Shqipërisë) për në ( ) me fluturimin nr. ( ), koha e nisjes ( ) dhe mbërritja në aeroport ( ) në orën ( )";

(d) emri i familjes dhe emrin(at) të tjerë, data e lindjes dhe vendi i lindjes së personit që do të kthehet, numri i dosjes dhe data e përgjigjes në kërkesën për ripranim

(e) tregues i varësisë eventuale nga ndihma, etj, për shkak të sëmundjes ose moshës

(f) tregoni nëse mund të priten incidente, me qëllim që të sigurohet shoqërimi zyrtar.

(3) Në çdo rast kur Autoriteti Kompetent i Palës Kontraktuese kërkuese nuk mund të kthejë personin që do të kthehet në datën e përcaktuar në njoftim, ai menjëherë do të informojë me shkrim Autoritetin Kompetent të Palës Kontraktuese të kërkuar për këtë fakt.

NENI IX

Postat kufitare

Kthimi i një personi sipas Marrëveshjes do të bëhet në pikat vijuese kufitare:

(a) në Mbretërinë e Bashkuar në çdo aeroport që përdoret për fluturime tregtare ndërkombëtare;

(b) në Republikën e Shqipërisë në aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit.

NENI X

Shpenzimet

(1) Shpenzimet brenda Nenit 19, të Marrëveshjes që do të paguhen nga Pala Kontraktuese kërkuese përfshijnë (por nuk do të kufizohen në) shpenzimet të arsyeshme që kanë të bëjnë me lëshimin e dokumenteve të udhëtimit. personin që do të kthehet ose kalojë tranzit dhe shpenzimet totale të transportit ajror dhe të çdo shoqërimi të nevojshëm.

(2) Për çdo kosto shtesë, Pala e Kërkuar Kontraktuese do t'u sigurojë një faturë Autoriteteve Kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese brenda pesëmbëdhjetë ditësh pune nga ripranimi, ose largimit në rastet e tranzitit. Të gjitha shpenzimet do t'i paguhen përfaqësimit diplomatik-konsullor të Palës Kontraktuese të kërkuar brenda tridhjetë ditëve nga marrja e një fature të tillë, ose, në rastin e Republikës së Shqipërisë, tek Autoriteti Kompetent ku ka lëshuar një faturë të tillë.

NENI XI

Mbrojtja e të dhënave

1) Secila Palë Kontraktuese nuk do të përdorë, zbulojë ose ruajë çdo informacion të ndarë në përputhje me këtë Marrëveshje për ndonjë qëllim, përveç për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

2) Autoritetet Kompetente mund, për qëllim të përpunimit të kërkesave, kthimeve dhe ripranimit sipas kësaj Marrëveshjeje, të zbulojnë informacionin e marrë në bazë të kësaj Marrëveshjeje tek autoritetet e tjera vendase përgjegjëse për ndjekjen e të njëjtit qëllim si ata të kryejnë detyrat e tyre zyrtare siç kërkohet nga dhe/ose lejohet sipas tyre. e drejta e brendshme.

3) Secila palë kontraktuese do të sigurojë që klasifikimi i sigurisë dhe çdo kufizim, kusht ose udhëzim i veçantë i trajtimit janë shënuar në mënyrë adekuate në të gjithë informacionin e ndarë në përputhje me këtë Marrëveshje. Për të parandaluar zbulimin, kopjimin, përdorimin, modifikimin ose asgjësimin e paautorizuar të informacionit të marrë në bazë të kësaj Marrëveshjeje, Secila Palë Kontraktuese do të kufizojë hyrjen në informacion për ata që kanë nevojë gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare me qëllim të përpunimit të kërkesave, kthimet dhe ripranimet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe për të përdorur mekanizmat e njohur të sigurisë siç janë fjalëkalimet, kriptimi ose masa mbrojtëse të tjera të arsyeshme për të parandaluar hyrjen e paautorizuar. Secila palë kontraktuese do të sigurojë që të gjithë personat e autorizuar të kenë akses në informacionin e marrë sipas kësaj Marrëveshjeje janë trajnuar në mënyrë të përshtatshme për trajtimin dhe kufizimet e përdorimit që zbatohen për këtë informacion dhe synojnë të mbrojnë informacionin në një mënyrë në përputhje me këtë Marrëveshje.

4) Secila palë kontraktuese do të njoftojë tjetrën për çdo akses, përdorim, zbulim, modifikim ose asgjësim aksidental ose të paautorizuar të informacionit të marrë në bazë të kësaj Marrëveshjeje sa më shpejt të jetë e mundur pasi të jetë në dijeni të sigurisë ose shkeljes së privatësisë dhe, kur është e mundur, t'i sigurojë tjetrit të gjitha detajet e nevojshme të aksesit aksidental ose të paautorizuar, përdorimit, zbulimit, modifikimit ose asgjësimit të këtij informacioni sa më shpejt të jetë e mundur.

5) Secila palë kontraktuese do t'i sigurojë palës tjetër informacionin më aktual dhe të saktë të disponueshëm. Në rast se kuptohet se informacioni në të cilin mbështetet është i pasaktë, ai do të njoftojë menjëherë tjetrin dhe do të sigurojë informacion korrigjues, aty ku është në dispozicion. Kur një Palë Kontraktuese merr një informacion korrigjues, ajo Palë do të korrigjojë, shënojë ose hedhë informacione të pasakta dhe çdo informacion që rrjedh prej saj, në përputhje me ligjet e saj të brendshme.

6) Secila palë kontraktuese konfirmon se ka vendosur një sistem me anë të të cilit individët mund të kërkojnë informacion në lidhje me veten e tyre që është shpërndarë në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe, kur ai informacion është i ditur për individin, mund të kërkojë një korrigjim të këtij informacioni. Secila palë kontraktuese konfirmon se ka një sistem të vendosur përmes të cilit individët mund të kërkojnë të korrigjojnë ose të sfidojnë një vendim që të mos ua zbulojë informacionin e tyre personal.

7) Secila Palë Kontraktuese do të vlerësojë rëndësinë e vazhdueshme të informacionit të marrë në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe do ta hedhë informacionin në mënyrë të sigurt kur nuk është më e rëndësishme në përputhje me ligjet e saj të brendshme.

8) Secila Palë Kontraktuese mund të kërkojë siguri nga pala tjetër se politikat e mjaftueshme, masat mbrojtëse ligjore ose teknike po mirëmbahen në lidhje me informacionin e ndarë sipas kësaj marrëveshjeje dhe mund të kërkojnë një rishikim të masave mbrojtëse.

9) Palët Kontraktuese do të rishikojnë angazhimet për ndarjen e të dhënave sipas kësaj marrëveshjeje. Rishikimi i parë do të bëhet jo më herët se një vit nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe jo më vonë se 5 vjet nga data e hyrjes së saj në fuqi, dhe siç Palët vendosin reciprokisht pas kësaj.

NENI XII

Komiteti i Ekspertëve

(1) Komiteti i Ekspertëve i krijuar në përputhje me Nenin 17, të Marrëveshjes do të përbëhet nga përfaqësues të secilës Palë Kontraktuese. Secila palë kontraktuese do të caktojë një ekspert kryesor dhe deri në 2 anëtarë për të shërbyer në Komitet. Një kryetar do të emërohet nga eksperti kryesor (ose një person i emëruar nga eksperti kryesor) në cilëndo Palë Kontraktuese, e cila do të presë takimin. Ekspertë që nuk janë anëtarë të Komitetit mund të ftohen nga një ekspert kryesor (ose një person i emëruar nga një ekspert kryesor) në seancat e Komitetit.

(2) Autoritetet Kompetente të Palëve Kontraktuese do të njoftojnë brenda tridhjetë ditëve nga nënshkrimi i Marrëveshjes tek Autoritetet Kompetente të Palës tjetër Kontraktuese emrat e përfaqësuesve të tyre në Komitetin e Ekspertëve.

(3) Autoritetet Kompetente të Palëve Kontraktuese do të njoftojnë brenda tridhjetë ditëve Autoritetet Kompetente të Palës tjetër Kontraktuese për çdo ndryshim në përbërjen e përfaqësimit të tyre në Komitetin e Ekspertëve.

(4) Ndër detyrat e Komitetit të Ekspertëve do të jenë:

(a) paraqitja e propozimeve tek Autoritetet Kompetente të Palëve Kontraktuese në mënyrë që të zgjidhen çështjet e mundshme dhe praktike që kanë lindur në zbatimin e Marrëveshjes;

(b) propozime te Autoritetet Kompetente të Palëve Kontraktuese në lidhje me ndryshimet dhe shtesat e Marrëveshjes;

(c) monitorimi i zbatimit të Marrëveshjes; dhe

(d) përgatitja dhe rekomandimi i masave të duhura për luftën e imigracionit të paligjshëm në përgjithësi.

(5) Palët Kontraktuese rezervojnë të drejtën të miratojnë propozime nga Komiteti Ekspertëve ose të mos e bëjnë atë.

(6) Komiteti do të mblidhet me propozimin e njërit prej ekspertëve kryesorë.

NENI XIII

Statusi i Protokollit

Ky Protokoll është pjesë integrale e Marrëveshjes.

NENI XIV

Zbatimi territorial.

Ky protokoll do të zbatohet:

(a) në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar:

(i) në Angli dhe Uells, Skoci dhe Irlandën e Veriut;

(ii) në territorin e Gjibraltarit; dhe

(ii) në çdo territor për marrëdhëniet ndërkombëtare për të cilat Mbretëria e Bashkuar është përgjegjëse dhe për të cilin do të shtrihet ky Protokoll, në varësi të çdo modifikimi të rënë dakord, me marrëveshje midis Palëve Kontraktuese. Një shtrirje e tillë mund të përfundojë nga secila Palë Kontraktuese duke i dhënë njoftim me shkrim tjetrit gjashtë muaj përmes kanalit diplomatik; dhe

(b) në Republikën e Shqipërisë

NENI XV

Hyrja në fuqi.

Ky Protokoll do të hyjë në fuqi me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

NENI XVI

Kohëzgjatja, Modifikimi, Pezullimi dhe Përfundimi

(1) Ky Protokoll përfundon për një periudhë të pacaktuar. Nëse një Palë Kontraktuese pezullon ose përfundon Marrëveshjen në përputhje me Nenin 25 të Marrëveshjes, ky Protokoll do të pezullohet ose përfundohet në përputhje me rrethanat, me një pezullim ose përfundim të tillë që hyn në fuqi në të njëjtën kohë me Marrëveshjen.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar siç duhet nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Nënshkruar në _____, më 2 (dy) origjinale, në gjuhën shqipe dhe angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje midis teksteve në gjuhët angleze dhe shqipe, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:	Për Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut:
Ministri i Brendshëm Bledar Çuçi	Ministri i Brendshëm Priti Patel

LIGJ
Nr. 127/2021

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 34, DATË 3.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 137/2020, 'PËR BUXHETIN E VITIT 2021', TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 34, datë 3.12.2021, i Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020, 'Për buxhetin e vitit 2021', të ndryshuar".

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 20.12.2021.

LIGJ
Nr. 130/2021

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 55/2015, "PËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Në nenin 36 fjalët "data 31 dhjetor 2021" zëvendësohen me fjalët "data 31 dhjetor 2023".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 20.12.2021.

URDHËR
Nr. 1, datë 6.1.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 11, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ**:**

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, zëvendësministrit të Brendshëm, znj. Romina Kuko, nga data 6.1.2022 deri më datë 10.1.2022.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Brendshëm, znj. Romina Kuko.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

VENDIM
Nr. 246, datë 13.12.2021

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN NËNTOR 2021

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar me vendimet e Bordit nr. 144, datë 25.6.2018, dhe nr. 233, datë 20.12.2019; nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 151/5 prot., datë 10.12.2021, e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2021",

konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën e saj nr. 10315 prot., datë 1.12.2021, të protokolluar me tonën nr. 286/10 prot., datë 3.12.2021, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin nëntor 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Bazuar në kërkesën e FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit**,** bazuar në vendimin nr. 212, datë 15.12.2020, "Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021" është 0.75 lekë/kwh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV**,** bazuar në vendimin nr. 213, datë 15.12.2020, të Bordit të ERE-s, "Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes, sipas nivelit të tensionit për vitin 2021" është 1.5 lekë/kwh.

- Në zbatim të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", të ndryshuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përllogaritjet e konsideruara nga ERE mbështetur në këtë aplikim për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF-ja për muajin nëntor 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse, si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Nentor 2021

Nëntor 2021			**Sipas aplikimit të FSHU sh.a.**	**Sipas Përllogaritjeve të ERE**
		Njësia	**Çmimi**	**Çmimi**
CBEt	të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	**33.679**	33.679
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	1.01	1.01
Çmimi mesatar i blerjes ne periudhen relevante		Leke/kWh	34.69	34.69
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA		**Leke/kWh**	**38.73**	**38.73**

- Bazuar në çdo element të formulës përllogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikim, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2021, të jetë 38.73 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë

së Fundit 38.73 lekë/kwh për muajin nëntor 2021.

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 247, datë 13.12.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DISA SHTESA NË RREGULLOREN "PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES", MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 166, DATË 10.10.2016, TË BORDIT TË ERE-s, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, nenit 16, pika 3 dhe nenit 20, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 151 prot., datë 3.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe e Inspektimeve dhe Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve, "Mbi fillimin e procedurave për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes", miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, të ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016, të Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, miratoi "Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes", të ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 177, datë 8.11.2016.

- Lidhur me këtë Rregullore, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), me shkresën nr. 5393 prot., datë 30.8.2021, ka paraqitur në ERE dy kërkesa për t'u reflektuar në rregulloren "Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes".

- ISHTI parashtron në ERE 2 (dy) kërkesa: së pari, përfshirjen në rregulloren "Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes" të detyrimit të subjektit që kërkon të pajiset me lidhje të re, për të bërë regjistrimin pranë ISHTI-t përpara vënies në shfrytëzim (dhënies së tensionit), vërtetuar me dokumentin përkatës të lëshuar prej tij; dhe së dyti, në pikën 2.1 të kësaj rregullore, për lidhje të reja në tensionin e ulët (TU), fuqia e instaluar 0–20 kw, të kërkohet nga ana e aplikantit projekti elektrik përkatës.

- Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi për mbikëqyrjen e tregut në industrinë joushqimore, kërkesat e parashtruara nga ISHTI i shërbejnë harmonizimit të legjislacionit në fuqi dhe, konkretisht, mbikëqyrjes dhe monitorimit të lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes dhe bazohen në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; në ligjin nr. 10489, datë 15.11.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar; në VKM-në nr. 245, datë 30.3.2016, "Për miratimin e rregullit teknik për kërkesat teknike në instalimin dhe kontrollin e dispozitivit diferencial, vendosur në pajisjet dhe instalimet elektrike dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara"; në VKM-në nr. 482, datë 17.6.2020, "Për miratimin e rregullit teknik për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV"; si dhe në VKM-në nr. 483, datë. 17.6.2020, "Për miratimin e rregullit teknik për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë mbi 1 kV".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për disa shtesa në rregulloren "Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes", të miratuar me vendimin e Bordit

të ERE-s nr. 166, datë 10.10.2016, të ndryshuar.

a) Te pjesa II, "Dokumentacioni i kërkuar për aplikim për lidhje të re", për lidhje të reja në TU, në pikën 2.1, pas pikës 2.1.6, propozohet të shtohet pika 2.1.7, me përmbajtje: "Vërtetimin e regjistrimit pranë ISHTI-t përpara vënies në shfrytëzim (dhënies së tensionit) vërtetuar me dokumentin përkatës".

b) Te pjesa II, "Dokumentacioni i kërkuar për aplikim për lidhje të re", për lidhje të reja në TU, në pikën 2.1, pas pikës 2.1.8, propozohet të shtohet pika 2.1.8, me përmbajtje: "Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë".

2. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe e Inspektimeve të njoftojë palët e përfshira për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 248, datë 13.12.2021

MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 110, DATË 26.4.2021, "MBI KËRKESËN E SHOQËRISË *"BIOPOWER GREEN ENERGY"* SHPK, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 35, DATË 4.2.2021, "MBI KËRKESËN E SHOQËRISË *'BIOPOWER GREEN ENERGY'* SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 90, DATË 6.8.2008, TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 53, pikat 2 dhe 3, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 151/6 prot., datë 10.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi rishikimin e vendimit nr. 110, datë 26.4.2021, "Mbi kërkesën e shoqërisë *"Biopower Green Energy"* sh.p.k, për rishikimin e vendimit nr. 35, datë 4.2.2021, "Mbi kërkesën e shoqërisë" sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 110, datë 26.4.2021, ndër të tjera vendosi:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë *"Biopower Green Energy"* sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2021, sipas kushteve të cituara në këtë vendim, me objekt rishikimi nga ERE pas përfundimit të afatit 3-mujor.

2. Të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2021.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE ka njoftuar shoqërinë duke i sjellë në vëmendje detyrimin për të plotësuar brenda afateve dokumentacionin e kërkuar në këtë vendim.

- Brenda afatit të vendosur në vendimin nr. 110/2021, shoqëria *"Biopower Green Energy"* sh.p.k. ka përcjellë argumente dhe dokumentacion, në lidhje me plotësimin e kushteve të këtij vendimi. Shoqëria ka depozituar korrespondencën e zhvilluar mes saj, AIDA-s (Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve) dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM). Në komunikimin e fundit të datës 7.12.2020, AKM-ja konstaton se aplikimi i shoqërisë *"Biopower Green Energy"* sh.p.k. do të merret në rishqyrtim pas plotësimit të këtyre dokumenteve/informacioneve të munguara.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 219, datë 27.10.2021, vendosi të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen, në lidhje me plotësimin e kushteve të vendimit të Bordit nr. 110, datë 26.4.2021.

- Në zbatim të urdhrit të kryetarit të ERE-s, nr. 77, datë 9.11.2021, në datën 23.11.2021, ishte planifikuar për t'u zhvilluar seanca dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë *"Biopower Green Energy"* sh.p.k. (seancë e cila, në bazë të kërkesës së vetë shoqërisë u zhvillua në datën 2.12.2021).

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 3.2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 110/2021, që ka të bëjë me lejen e mjedisit, shoqëria ka bërë me dije se nga takimet me Agjencinë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA), doli në pah se për të vijuar me aplikimet, sipas procedurave ligjore, duhet të merret më parë autorizimi paraprak nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Pa autorizimin paraprak të MIE-s, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) nuk mund të pranojë aplikimin për leje mjedisore, i cili sikurse dokumentohet edhe më herët në ERE është bërë dy herë dhe është refuzuar për arsyen e sipërcituar. Në këto rrethana, shoqëria është shprehur se po procedon me aplikim pranë MIE-s, që më pas të mund të aplikojnë sërish pranë MTM-së për t'u pajisur me leje mjedisore. Bashkëlidhur shoqëria ka përcjellë në ERE shkresa të cilat lidhen me ecurinë e zbatimit të hapave për të realizuar projektin eolik, në kuadër të statusit të investitorit strategjik. Në vijim të sa depozitohet, në seancën dëgjimore shoqëria mbajti të njëjtin qëndrim dhe ka deklaruar se është e detyruar t'i nënshtrohet kërkesave të autoriteteve përkatëse, në lidhje me marrjen e të gjitha lejeve dhe autorizimeve për të vijuar me zbatimin dhe vënien në punë të projektit eolik, kjo edhe në kuadër të Statusit të Investitorit Strategjik, me të cilin është pajisur. Në këto rrethana, shoqërisë iu kërkua të qartësojë/saktësojë marrëdhënien e saj me ERE-n, në kuadër të mbajtjes ose jo të licencës që disponon. Përfaqësuesi i shoqërisë deklaroi se në vijim do të merrte pjesë në një takim me MIE-n, në kuadër të pajisjes me miratim paraprak dhe se në këto rrethana ishte i paqartë për të përcaktuar vazhdimësinë ose jo të licencës së lëshuar nga ERE. Për sa bëhet me dije nga shoqëria, iu kërkua kësaj të fundit, që në takimin me MIE-n të qartësonte statusin e saj dhe të informojë ERE-n në lidhje me angazhimin e saj, në lidhje me plotësimin e kushteve të licencimit e, rrjedhimisht nëse do të vazhdojë marrëdhënien me ERE-n në kuadër të licencës që disponon. Në rrethanat kur shoqëria nuk ka kthyer ende një përgjigje për sa kërkohet në seancë, por duke marrë në konsideratë të gjitha përpjekjet e bëra nga ana e saj për t'u pajisur me leje mjedisore, si një nga kushtet e vendosura nga ERE, vlerësohet të zgjatet më tre muaj vendimmarrja e ERE-s, për t'i dhënë mundësi shoqërisë që të informojë ERE-n në lidhje me statusin e saj referuar licencës me të cilën është pajisur nga ERE dhe plotësimit të kushteve respektive të vendimit të licencimit.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 4, të vendimit nr. 110/2021, që ka të bëjë me dokumentacionin ligjor vërtetues mbi realizimin e investimeve për zbatimin e projektit eolik, ka depozituar në ERE fatura blerje dhe shitje, si edhe dokumente bankare, të cilat bashkëngjiten faturave si provë. Sa më sipër rezulton se shoqëria ka depozituar dokumentacion në plotësim të këtij kushti, por ERE rezervon të drejtën për t'u shprehur, pasi shoqëria të qartësojë statusin e saj. Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 5, të vendimit nr. 110/2021, që ka të bëjë me përditësimin në mënyrë periodike në ERE mbi statusin e realizimit të planit të veprimit, në zbatim të vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 11/6, datë 4.2.2021, shoqëria ka depozituar në ERE informacion në lidhje me ecurinë e realizmit të këtij plani, ku sqaron se afati i statusit është deri në datën 4.2.2023. Gjithashtu, shoqëria ka shpjeguar se me qëllim respektimin e zonave të mbrojtura, është parë i vlefshëm spostimi i dy turbinave. Po ashtu është paraqitur dhe një raport vëzhgimi i rrugëve të transportit për projektin Shëngjin dhe Balldren. Në bazë të parashikimeve dhe të marrjes së të gjitha lejeve dhe autorizimeve përkatëse, shoqëria parashikon vendosjen në punë të centralit brenda majit të vitit 2023. Sa më sipër, rezulton se shoqëria ka depozituar dokumentacion në plotësim të këtij kushti, por ERE rezervon të drejtën për t'u shprehur, pasi shoqëria të qartësojë statusin e saj.

- Me qëllim qartësimin e statusit të saj referuar licencës me të cilën është pajisur nga ERE dhe plotësimin e kushteve respektive të vendosura në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 110/2021, vlerësohet që të zgjatet afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s me 3 (tre) muaj për shoqërinë *"Biopower Green Energy"* sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 3 (tre) muaj afatin e vendimmarrjes së ERE-s për plotësimin e kushteve të vendosura në vendimit nr. 110, datë 26.4.2021.

2. Brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, shoqëria *"Biopower Green Energy"* sh.p.k. të qartësojë statusin e saj referuar licencës me të cilën është pajisur nga ERE dhe kushteve përkatëse.

3. Shoqëria *"Biopower Green Energy"* sh.p.k. të informojë/dokumentojë në ERE çdo muaj ecurinë e plotësimit të kushtit të vendosur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me informacionin/dokumentacionin e përditësuar, sipas pikës 2 të këtij vendimi apo aktet ligjore, apo nënligjore të dala nga organet kompetente.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë kërkuesin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 249, datë 13.12.2021

MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 111, DATË 26.4.2021, "MBI KËRKESËN E SHOQËRISË 'E-VENTO SRL ALBANIA' SHPK, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 32, DATË 4.2.2021, 'MBI KËRKESËN E SHOQËRISË 'E-VENTO SRL ALBANIA' SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 84, DATË 17.7.2008, TË NDRYSHUAR'"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 53, pika 2 dhe 3, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 151/7 prot., datë 10.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi rishikimin e vendimit nr. 111, datë 26.4.2021, 'Mbi kërkesën e shoqërisë 'E-Vento s.r.l. Albania' sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2021, 'Mbi kërkesën e shoqërisë 'E-Vento s.r.l. Albania' sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar'",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 111, datë 26.4.2021, vendosi:

"1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë 'E-Vento s.r.l. Albania' sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2021, sipas kushteve të cituara në këtë vendim, me objekt rishikimi nga ERE pas përfundimit të afatit 3-mujor.".

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE ka njoftuar shoqërinë duke i sjellë në vëmendje detyrimin për të plotësuar brenda afateve dokumentacionin e kërkuar në këtë vendim.

- Brenda afatit të vendosur në vendimin nr. 111/2021, shoqëria "E-Vento s.r.l. Albania" sh.p.k. ka përcjellë argumente dhe dokumentacion, në lidhje me plotësimin e kushteve të këtij vendimi.

- Nga shqyrtimi paraprak i këtij dokumentacioni, rezultoi se shoqëria kishte referuar se është në proces për t'u pajisur me dokumentacionet përkatëse nga organe të tjera shtetërore, siç janë bashkitë, në lidhje me dokumentet e pronësisë, apo Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), në lidhje me lejen mjedisore, ndaj ERE i dërgoi shkresa këtyre institucioneve për të marrë një informacion të saktë në lidhje me fazën në të cilën ndodhet pajisja me këto dokumente apo leje.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 219, datë 27.10.2021, vendosi të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen, në lidhje me

plotësimin e kushteve të vendimit të Bordit nr. 111, datë 26.4.2021.

Në zbatim të urdhrit të kryetarit të ERE-s nr. 79, datë 9.11.2021, në datën 22.11.2021, në ambientet e ERE-s është zhvilluar seanca dëgjimore me përfaqësuesin e shoqërisë "E-Vento s.r.l. Albania" sh.p.k., i cili ka sqaruar/argumentuar mbi dokumentacionin e depozituar dhe plotësimin e kushteve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 111/2021.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 3.1, të vendimit nr. 111/2021, ku përcaktohet se shoqëria duhet të depozitonte në ERE, brenda 3 muajve, studimin e fizibilitetit, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit, duke përcaktuar në këtë studim koston e prodhimit të energjisë elektrike, të shoqëruar dhe me grafikun e rishikuar të punimeve, shoqëria, gjatë seancës dëgjimore dhe me shkresën e dërguar në vijim të saj, ka deklaruar se ka marrë ofertë zyrtare për vendosjen e anemometrave duke marrë të dhënat përfundimtare të studimit të erës, që do të shërbejnë për hartimin e studimit të fizibilitetit. Shoqëria ka kërkuar një afat prej 14 muajsh (12 muaj për matje të erës nga momenti i vendosjes së anemometrave dhe 2 muaj për hartimin e studimit të fizibilitetit). Në lidhje me afatin e kërkuar vlerësohet se është i mjaftueshëm afati prej 12 muajsh, pasi studimi i fizibilitetit mund të hartohet njëkohësisht me marrjen e të dhënave nga matja e shpejtësisë së erës.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 3.2, të vendimit nr. 111/2021, që ka të bëjë me lejen mjedisore, shoqëria ka dokumentuar në ERE aplikimin e bërë në sistemin *online,* e-Albania, në datën 16.8.2021, së bashku me të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe bën me dije se është në pritje të pajisjes me lejen mjedisore, pasi janë ezauruar të gjithë hapat procedural teknik në sistemin elektronik të *e-Albania.* Në lidhje me këtë kusht, sa dokumentuar nga shoqëria për kryerjen e aplikimit për rinovimin e lejes mjedisore, është konfirmuar dhe nga vetë AKM-ja.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 4, germa "a", të vendimit nr. 111/2021, që ka të bëjë me dokumentacionin ligjor vërtetues, mbi realizimin e investimeve për zbatimin e projektit eolik, konstatohet së shoqëria e ka plotësuar pjesërisht këtë kusht, me depozitimin e bilanceve dhe të shlyerjes së disa pagesave. Në kuadër të përditësimit periodik të ecurisë së kushteve shoqëria duhet të depozitojë dhe dokumentacionin përkatës vërtetues për realizimin e investimeve.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 4, germa "b", të vendimit nr. 111/2021, që ka të bëjë me dokumentacionin pronësor për të gjithë sipërfaqen e nevojshme, për realizimin e projektit, shoqëria ka deklaruar se ka filluar punën për rinovimin/lidhjen e kontratave të reja të qirasë, për të gjithë sipërfaqen ku do të zhvillohet projekti, por në bazë të legjislacionit në fuqi, duhet të bëhet regjistrimi i kontratave të qirave pranë drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK), por kjo zonë nuk është hedhur ende në sistemin e digjitalizuar kadastral. Shoqëria ka vendosur ta kryejë vetë këtë proces nëpërmjet shoqërisë së projektimit dhe supervizionit Zenit & Co sh.p.k. dhe për të përfunduar të gjithë procedurën, sipas përcaktimeve përkatëse ligjore, ajo deklaron se i nevojitet një afat kohor prej 12 muajsh.

Sa më sipër përcjellë e dokumentuar nga shoqëria, rezulton se nuk është depozituar ende dokumentacioni pronësor për të gjithë sipërfaqen e projektit siç kërkohet specifikisht në këtë kusht. Për sa i takon afatit të kërkuar nga shoqëria, vlerësojmë se duhet t'i lihet në dispozicion një afat kohor prej 9 muajsh, duke konsideruar se bashkitë janë shprehur se afati procedural për rinovimin/lidhjen e kontratës së re është 6 muaj nga momenti i fillimit të procedurave. Përveç kësaj, vlerësohet t'i lihet shoqërisë një afat kohor prej 3 muajsh për përgatitjen e dokumentacionit topografik në formatin e kërkuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

- Si përfundim, shoqëria është shprehur se afatet konkrete të kërkuara nga ana e saj për plotësimin e secilit kusht, janë të përafërta dhe se ajo kërkon një shtyrje afati total prej 36 muajsh, afat ky që do t'i japë siguri me investitorin e huaj. Në lidhje me këtë pretendim, vlerësohet se afati nuk është i justifikuar, pasi jo të gjitha kushtet janë komplementare të njëra-tjetrës dhe afati nuk mund të kërkohet në mënyrë kumulative, ndaj ERE ka vlerësuar dhe arsyetuar zgjatjen konkrete

për plotësimin e secilit kusht, konkretisht 12 muaj për depozitimin e studimit të fizibilitetit dhe 9 muaj për depozitimin e lejes së mjedisit dhe dokumentacionit përkatës pronësor, si dhe përditësimin periodik me dokumentacionin përkatës vërtetues për realizimin e investimeve.

- Referuar faktit që shoqëria ka filluar procedurat për plotësimin e këtyre kushteve, vlerësohet t'i lihet detyrimi që të informojë/dokumentojë në ERE çdo muaj ecurinë e plotësimit të tyre. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me përditësimin e plotësimit të kushteve nga shoqëria, apo akteve ligjore apo nënligore të dala nga organet e tjera.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 12 (dymbëdhjetë) muaj afatin e plotësimit të kushtit të vendosur në pikën 3.1 (studimi i fizibilitetit), të vendimit nr. 111, datë 26.4.2021.

2. Të zgjasë me 9 (nëntë) muaj afatin e plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 3.2 dhe pikën 4, germat "a" dhe "b" (leja e mjedisit, dokumentacioni pronësor dhe dokumentacioni përkatës vërtetues për realizimin e investimeve), të vendimit nr. 111, datë 26.4.2021.

3. Shoqëria "E-Vento s.r.l. Albania" sh.p.k. të informojë/dokumentojë në ERE çdo muaj ecurinë e plotësimit të këtyre kushteve.

4. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me informacionin/dokumentacionin e përditësuar sipas pikës 3, të këtij vendimi, apo aktet ligjore apo nënligjore të dala nga organet e tjera.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë kërkuesin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 250, datë 13.12.2021

MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 112, DATË 26.4.2021, "MBI KËRKESËN E SHOQËRISË 'HERA' SHPK, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 34, DATË 4.2.2021, 'MBI KËRKESËN E SHOQËRISË 'HERA' SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 61, DATË 2.11.2007, TË NDRYSHUAR'"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 53, pikat 2 dhe 3, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 151/8 prot., datë 10.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi rishikimin e vendimit nr. 112, datë 26.4.2021, 'Mbi kërkesën e shoqërisë 'Hera' sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 34, datë 4.2.2021, 'Mbi kërkesën e shoqërisë 'Hera' sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar'",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 112, datë 26.4.2021, vendosi:

"1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë 'HERA' sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 34, datë 4.2.2021, sipas kushteve të cituara në këtë vendim, me objekt rishikimi nga ERE pas përfundimit të afatit 3-mujor.

2. Të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE-s nr. 34, datë 4.2.2021.".

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE ka njoftuar shoqërinë duke i sjellë në vëmendje detyrimin për të plotësuar brenda afateve dokumentacionin e kërkuar në këtë vendim.

- Brenda afatit të vendosur në vendimin nr. 112/2021, shoqëria "Hera" sh.p.k. ka përcjellë argumente dhe dokumentacion në lidhje me plotësimin e kushteve të këtij vendimi.

- Nga shqyrtimi paraprak i këtij dokumentacioni, rezultoi se shoqëria ka referuar se

është në proces për t'u pajisur me dokumentacionet përkatëse nga organe të tjera shtetërore, siç janë bashkitë, në lidhje me dokumentet e pronësisë apo Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), në lidhje me lejen mjedisore. ERE i dërgoi shkresa këtyre institucioneve për të marrë një informacion të saktë, në lidhje me fazën në të cilën ndodhet pajisja me këto dokumente apo leje.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 219, datë 27.10.2021, vendosi të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen e tij, në lidhje me plotësimin e kushteve të vendimit të Bordit nr. 112, datë 26.4.2021.

- Në zbatim të urdhrit të kryetarit të ERE-s nr. 79, datë 9.11.2021, në datën 23.11.2021, në ambientet e ERE-s është zhvilluar seanca dëgjimore me përfaqësuesin e shoqërisë "Hera" sh.p.k., i cili ka sqaruar/argumentuar mbi dokumentacionin e depozituar dhe plotësimin e kushteve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 112/2021.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 3.1, të vendimit nr. 112/2021, që ka të bëjë me kontratat e rinovuara të qirasë me bashkitë përkatëse, për të gjithë sipërfaqen e nevojshme për realizimin e projektit, shoqëria bën me dije se ka marrë miratimin, për fillimin e procedurave, për rilidhjen e kontratave të qirasë së tokës me Bashkinë Pogradec dhe se kjo e fundit ka shprehur interesin për të bashkëpunuar me shoqërinë "Hera" sh.p.k. Shoqëria "Hera" sh.p.k. i është drejtuar bashkive Devoll dhe Maliq me kërkesën për rinovimin/lidhjen e kontratës me objekt dhënien me qira të fondit pyjor/kullosor subjektit "Hera" sh.p.k., në kuadër të zhvillimit të parkut eolik "KAPPET". Bashkia Maliq ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim me shoqërinë "Hera" sh.p.k., pasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet. Gjithashtu, shoqëria ka deklaruar se këto procedura do të kërkojnë përgatitjen e dokumentacionit topografik në formatin e kërkuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), dokumentacion i cili nuk posedohet nga bashkitë, për rrjedhojë shoqëria "Hera" sh.p.k. do ta përgatisë këtë dokumentacion me shpenzimet e veta.

Pavarësisht se ky kusht nuk mund të konsiderohet i plotësuar tërësisht, shoqëria ka dokumentuar korrespondencat përkatëse me bashkitë për të filluar procedurën, për t'u pajisur me dokumentacionin pronësor respektiv, në kuadër të plotësimit të kushtit të vendimit nr. 112/2021.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 3.2, të vendimit nr. 112/2021, që ka të bëjë me lejen mjedisore të rinovuar, shoqëria ka dokumentuar në ERE aplikimin e bërë në sistemin *online* nëpërmjet platformës *e-Albania*, për vlerësimin e ndikimit në mjedis, së bashku me dokumentacionin mbështetës. Ky kusht i vendimit mbetet ende i pa plotësuar, shoqëria rezulton se është në proces për t'u pajisur me lejen mjedisore të rinovuar.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 4, germa "a", të vendimit nr. 112/2021, që ka të bëjë me miratimin e plotë nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve**,** shoqëria bën me dije se po vijon me përgatitjen e raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor të zonës, me përfundimin e të cilit do të aplikojë në sistemin *e-Albania*, dhe më tej do të jetë në pritje të vendimmarrjes së Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) pranë Ministrisë së Kulturës.

Ky kusht mbetet ende i pa plotësuar pasi për të marrë miratimin e KKTKM-së, nevojitet më parë kryerja e vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor, të cilin shoqëria deklaron se e ka në proces.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 4, germa "b", të vendimit nr. 112/2021, që ka të bëjë me dokumentacionin ligjor vërtetues, mbi realizimin e investimeve për zbatimin e projektit eolik, shoqëria "Hera" sh.p.k. ka depozituar në ERE pasqyrat financiare vjetore të përgatitura nga ekspertët kontabël dhe investimet e kryera nga vetë ajo në harkun kohor 2007–2021. Në lidhje me këtë kusht, rezulton që shoqëria ka depozituar dokumentacion në ERE, që vërteton kryerjen e investimeve, në kuadër të zhvillimit të projektit eolik deri në momentin e depozitimit të këtij dokumentacioni në ERE. Në vijim, shoqërisë vlerësohet t'i lihet ende ky kusht, në kuadër të dokumentimit të investimeve që do të kryejë, deri në plotësimin e të gjitha kushteve dhe finalizimin e projektit.

- Në lidhje me shkresën e dërguar nga shoqëria në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), konstatohet se ajo ka përcjellë matjet e kryera, me qëllim marrjen e një mendimi në lidhje me nivelin e standardeve të pritshmërisë së kërkuar për zhvillimin e këtyre projekteve dhe se shoqëria

ka shprehur angazhimin e saj për të vijuar me plotësimin e kushteve respektive të vendosura nga ERE.

- Në përfundim, shoqëria "Hera" sh.p.k. ka kërkuar nga ERE shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 112/2021, për të paktën 9 muaj, duke u angazhuar që të vendosë në dijeni ERE-n për çdo korrespondencë dhe zhvillim të proceseve në përmbushjen e kushteve dhe të kërkesave të saj.

- Për gjithë sa më sipër, referuar përpjekjeve të shoqërisë në kuadër të plotësimit të kushteve dhe kërkesës së saj për shtyrje, bazuar edhe në përgjigjet që vetë ERE ka marrë nga organet e tjera, vlerësohet se afati prej 9 muajsh, për plotësimin e secilit prej kushteve të vendimit nr. 112/2021, është i arsyetuar dhe duhet të merret në konsideratë.

- Shoqërisë "Hera" sh.p.k. t'i lihet detyrimi që të informojë/dokumentojë në ERE çdo muaj ecurinë e plotësimit të këtyre kushteve.

- ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me përditësimin e plotësimit të kushteve nga shoqëria, apo aktet ligjore apo nënligjore të dala nga organet e tjera.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 9 (nëntë) muaj afatin e plotësimit të kushteve të vendosura në pikat 3.1, 3.3 dhe pikën 4, germat "a" dhe "b" (leja e mjedisit, dokumentacioni pronësor, miratimi nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe dokumentacioni përkatës vërtetues për realizimin e investimeve), të vendimit nr. 112, datë 26.4.2021, nga shoqëria "Hera" sh.p.k.

2. Shoqëria "Hera" sh.p.k. të informojë/ dokumentojë në ERE çdo muaj ecurinë e plotësimit të këtyre kushteve.

3. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me informacionin/ dokumentacionin e përditësuar sipas pikës 2, të këtij vendimi, apo aktet ligjore apo nënligjore të dala nga organet kompetente.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë kërkuesin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 251, datë 13.12.2021

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN E KUOTAVE (NËPËRMJET SHITBLERJES) TË SHOQËRISË "KALISI HYDROPOWER" SHPK NDËRMJET ORTAKËVE EKZISTUES TË SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të pikës 6.2, të "Kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 151/9 prot., datë 10.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave (nëpërmjet shitblerjes) të shoqërisë 'Kalisi Hydropower' sh.p.k. ndërmjet ortakëve ekzistues të saj",

konstatoi se:

- Shoqëria "Kalisi Hydropower" sh.p.k. është mbajtëse e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 71, datë 22.4.2020.

- Shoqëria ka vënë në dijeni ERE-n për transferimin e kuotave ndërmjet ortakëve ekzistues të saj.

- Në zbatim të pikës 6.2, të "Kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike", të licencuarit mbartin detyrimin për të kërkuar autorizim në ERE, në lidhje me ndryshimin e ortakut/aksionarit kryesor.

- Të licencuarit mbartin detyrimin për të kërkuar autorizim në ERE, në lidhje me ndryshimin e

ortakut/aksionarit kryesor, në zbatim të pikës 6.2, të "Kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike".

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 218, datë 27.10.2021, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Kalisi Hydropower' sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave", vendosi:

"1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen e Bordit të ERE-s, mbi kërkesën e shoqërisë 'Kalisi Hydropower' sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave.".

- Kjo shtyrje erdhi si pasojë e nevojës për të sqaruar rrethanat dhe dokumentacionin që lidhet me barrësimin e kuotave te të tretët, për të cilat shoqëria ka kërkuar autorizimin e ERE-s për transferimin brenda shoqërisë dhe për zhvillimin e seancave të mundshme dëgjimore, për këtë qëllim, e për të sqaruar statusin e barrës siguruese që vetë shoqëria ka vendosur mbi këto kuota.

- Në seancën dëgjimore të datës 22.11.2021, përfaqësuesit e shoqërisë deklaruan se shoqëria ka marrë miratimin përkatës të bankës për këtë transferim, dokument i cili është depozituar në ERE.

- Në kuadër të kërkesës për marrjen e miratimit të ERE-s, për transferimin e kuotave (nëpërmjet shitblerjes) ndërmjet ortakëve ekzistues të saj, shoqëria ka depozituar informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm.

- Shoqëria ka depozituar në ERE shkresën drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për vënien në dijeni, për transferimin e kuotave ndërmjet shoqërive ortake ekzistuese të shoqërisë "Kalisi Hydropower" sh.p.k. Në lidhje me këtë njoftim që i ka bërë MIE-s, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, vetë shoqëria ka argumentuar në shkresën e saj drejtuar ERE-s se referuar nenit 17.1, të kontratës së koncesionit nr. 1605 rep., nr. 1057 kol., datë 18.7.2018, ku parashikohet se, për çdo transferim të aksioneve të kapitalit themeltar tek të tretët, koncesionari duhet të marrë pëlqim paraprak te autoritetit kontraktues, shoqëria si mbajtëse e koncesionit ka të drejtë që brenda saj të ndryshojë/transferojë aksionet e shoqërive të saj pa pëlqimin e autoritetit kontraktues, pasi në këtë rast nuk është transferim te të tretët, por transferim/shit-blerje e aksioneve brenda shoqërisë. Po ashtu, gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesit e ERE-s pyetën përfaqësuesit e shoqërisë, në lidhje me qëndrimin e MIE-s për sa informuar nga shoqëria, të cilët ritheksuan edhe një herë faktin se në zbatim të përcaktimeve të nenit 17.1, të kontratës koncesionare kanë vetëm detyrimin për të njoftuar MIE-n, në cilësinë e AK-së, pasi transferimi i kuotave nuk bëhet te të tretët.

- Në çdo rast, vlerësohet të theksohet se shoqëria nuk çlirohet nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet përkatëse nga organet e tjera, në lidhje me këtë transferim, kur kjo kërkohet nga këto organe.

- Shoqëria "Kalisi Hydropower" sh.p.k. ka shlyer të gjitha pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave (nëpërmjet shitblerjes) të shoqërisë "Kalisi Hydropower" sh.p.k. ndërmjet ortakëve ekzistues të shoqërisë.

2. Shoqëria "Kalisi Hydropower" sh.p.k. nuk çlirohet nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet përkatëse nga organet e tjera për këtë transferim, nëse kjo kërkohet nga këto organe.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 5
Datë: 2022/01/13 15:06:50
86dbdaed-c53c-44fe-871a-d89c2f92f3c2

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë